VENDIM
Nr.4, datë 2.2.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli, Anëtar i ““
Veli Budo, Anëtar i ““
Zija Vuci, Anëtar i ““
Franc Jakova, Anëtar i ““
Alfred Karamuço, Anëtar i ““
Halil Kopani, Anëtar i ““
Kristofor Peçi, Anëtar i ““
me sekretare Drita Filto, më datë 28.10.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.53/1 Akti, që i përket :
KËRKUES:
1. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE, i përfaqësuar nga juristi Vladimir Mulaj.
2. QAMIL TUSHA, ISH-GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPERISË, në mungesë
SUBJEKT I INTERESUAR: BANKA E SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga Z.Neritan Kallfa.

OBJEKTI:

Papajtueshmëria me Kushtetutën e gërmës “ç” të nenit 2 të Ligjit nr.8230, datë 6.8.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 “Për Bankën e Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e palës kërkuese, të subjektit të interesuar dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim për marrjen e vendimit, Kuvendi Popullor me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ka shfuqizuar Ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 “Për Bankën e Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme të tij, objekt kërkese. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se me daljen e ligjit të ri, çështja mbetet pa objekt, prandaj duhet të vendoset pushimi i gjykimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 e 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të çështjes.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.